



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 854 Prot.

Tiranë, më datë 1.7.2022

VENDIM

Nr. 326, datë 01.07.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.07.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Rindërtimi i objektit ekzistues 1 kat + podrum shtesë anësore dhe shtesë lartësi”, Brenda Kufirit Qendër Historike Korçë, me aplikues “Focus Architecture” sh.p.k. dhe zhvillues Xhuvri Sharxhi;
 - Të plotësohet projekti me dokumentacion grafik shtesë sa i takon marrëdhënies me objektin fqinj Monument Kulture Kategori I “Vëllazëria Lubonja”, në pjesën ku ballafaqohen me faqe kallkan;
 - Komiza e çatisë të mos tejkalojë atë të objektit Monument Kulture Kategori e I;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

